



REPUBLIKA E SHQIPERISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 135 Prot.

Tiranë, më 05/3/2015

REKOMANDIM

Nr. 10 / datë 05/3 /2015

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, si dhe neneve 80-104 të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”,

KONSTATOVA :

Në zbatim të Urdhërit nr. 238, datë 19.12.2014 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale është kryer inspektimi administrativ pranë kontrolluesit “*Instituti për Kërkime Ekonomike i Tiranës*” (TIER), me objekt:

- Verifikimi i zbatimit të kërkesave të nenit 21 e në vazhdim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, lidhur me “përgjegjësinë për të njoftuar”, të kontrolluesit;
- Verifikimi i ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale mbi “imazhet nëpërmjet kamerave të vëzhgim-regjistrimit (CCTV)” dhe të dhënave sensitive mbi “Shëndetin”.

“*Instituti për Kërkime Ekonomike i Tiranës*” (TIER) është person juridik jopublik, organizatë jofitimprurëse në fushën e kërkimeve ekonomike dhe sociale, që e ushtron veprimtarinë sipas qëllimeve të përcaktuara në Vendimin e Gjykatës nr. 3670, për “Regjistrimin si Person Juridik”. Gjatë aktivitetit të tij kontrolluesi përpunon të dhëna personale të punonjësve dhe të dhëna personale të personave të intervistuar/aksidentuar.

Zyra e Komisionerit konstaton se kontrolluesi TIER i përpunon të dhënat personale të personave të intervistuar, në zbatim të kontratës së nënshkruar me Bankën Botërore, për realizimin dhe implementimin e një studimi me temë “Siguria rrugore dhe varfëria, vlerësimi i kostove sociale dhe përfitimeve të grupeve vulnerabël nga rrugë të mira dhe më të sigurta”. Qëllimi i studimit është të analizojë rrezikun që sjell mungesa e kushteve të sigurisë rrugore në shtresat e ndryshme të popullsisë si dhe të vlerësojë ndikimin e aksidenteve rrugore në jetën e individëve të aksidentuar dhe familjeve të tyre. Në këtë kuadër synohet që ky informacion t’u bëhet i ditur institucioneve përgjegjëse për të marrë masat e duhura dhe përmirësuar sigurinë rrugore në Shqipëri. Ky studim ka filluar të realizohet në muajin nëntor dhe përfshin vetëm të dhënat mbi aksidentet e vitit 2012. Kontrolluesi vlerëson koston e

aksidenteve si dhe pasojat, përmes një vrojtimi duke intervistuar drejtpërdrejt personat e aksidentuar, familjet e prekura, si dhe përmes grupeve të fokusuara.

Zyra e Komisionerit konstaton se të dhënat personale mblidhen nëpërmjet formateve të pyetësorëve që plotësohen nga intervistuesi. Pyetësorët mbahen për një periudhë një vjeçare me qëllimin për të provuar vërtetësinë e intervistës. Të dhënat e mblidhura nëpërmjet pyetësorëve përpunohen më tej në mënyrë elektronike (përmes pajisjeve kompjuterike). Një pjesë e të dhënave që kontrolluesi mbledh lidhur me projektin e Bankës Botërore, dokumentohen në format Excel, aksesit në të cilin është i kufizuar. Të dhënat e administruara në format excel përpunohen më tej me qëllim përgatitjen e një raporti final për Bankën Botërore, i cili nuk do të përmbajë të dhëna personale por, vetëm statistika të agreguara mbi gjendjen e aksidenteve në Shqipëri për vitin 2012.

Kontrolluesi TIER, nëpërmjet formularit të njoftimit, të depozituar pranë Zyrës së Komisionerit në zbatim të nenit 21 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar ka deklaruar se përpunon të dhëna “*imazhe nëpërmjet kamerave të vëzhgim-regjistrimit (CCTV)*” për personat e intervistuar, me qëllim vërtetimin pranë donatorit të realizimit sa më të saktë të veprimtarisë intervistuese. Pas inspektimit, u konstatua se kontrolluesi nuk kishte përdorur një metodë të tillë intervistimi. Kjo pasi kontrolluesi kishte vlerësuar se kjo metodë nuk ishte e pranueshme nga të intervistuarit dhe nuk ishte në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Zyra e Komisionerit konstaton se kontrolluesi TIER, për kategorinë “persona të intervistuar”, mblledh dhe përpunon këto të dhëna: emër, mbiemër, moshë, shkalla aksidentit (duke evidentuar me 1 aksidentet me pasojë vdekje dhe me 2 aksidentet e rënda), adresa (qyteti/prefektura), të dhëna të pronësisë dhe numrin e telefonit të subjektit të të dhënave (person i aksidentuar ose familjarë).

Nga analizimi paraprak i formularit të njoftimit dhe dokumentacionit të administruar u konstatua se kontrolluesi nuk kishte deklaruar lidhur me përpunimin e të dhënave personale të pronësisë dhe numrat e telefonit (referuar rubrikës 4 të formularit të njoftimit). Pas lënies së procesverbalit të kontrollit administrativ, rezultoi se kontrolluesi TIER e ka realizuar detyrimin për përditësimin e njoftimit, (vërtetuar nga regjistri elektronik online i Zyrës së Komisionerit).

Zyra e Komisionerit konstaton se kontrolluesi TIER, në formularin e informimit të subjekteve të të dhënave personale, nuk ka parashikuar të drejtat që ata gëzojnë në kuadër të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, mënyrën se si do të përpunohen të dhënat, dhe mundësinë për të revokuar pëlqimin në çdo çast etj, në kundërshtim me nenin 18 të ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar. Informimi i subjekteve të të dhënave personale mbi të drejtat që gëzojnë në kuadër të ligjit garanton në mënyrë reale ushtrimin e këtyre të drejtave.

Zyra e Komisionerit konstaton se kontrolluesi nuk ka hartuar një Rregullore të Brendshme për “*Mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen, sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave personale*”, në zbatim të nenit 27 të ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar.

Për sa më sipër:

Në zbatim të neneve 18, 27, 28, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", si dhe 107-109 të Kodit të Procedurave Administrative,

REKOMANDOJ:

1. Në zbatim të nenit 18 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, të informohen subjektet e të dhënave (nëpërmjet formularit të informimit) mbi të drejtat që gëzojnë në kuadër të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe për mënyrën se si do të përpunohen të dhënat, duke i paraqitur mundësinë për të revokuar pëlqimin në çdo çast;
2. Në zbatim të nenit 27 dhe 28 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, të merren masa për hartimin e një rregullore të shkruar për "Mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen, sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave personale". (Rregulloren tip mund ta gjeni në faqen zyrtare www.idp.al, si dhe ofrojmë asistencën tonë).
3. Kryerja e këtyre detyrimeve të realizohet brenda një afati kohor prej 45 (dyzet e pesë) ditësh, nga momenti i marrjes dijeni të këtij rekomandimi.
4. Me plotësimin e këtyre detyrimeve të njoftohet me shkrim pranë Komisionierit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
5. Me kalimin e këtij afati në rast mos përmbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të rekomandimeve të tij, vendos sanksione për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave".

